

VENDIM
Nr. 34, datë 10.7.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR
NR. 41, DATË 6.10.2017, “ PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS GRAMSH” , I
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” , i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 10.7.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projektvendimit ‘Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 6.10.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës Gramsh”’, i ndryshuar”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës Gramsh (U Gramsh) me shkresën nr. 445 prot, datë 28.5.2019, me lëndë “Përcjellje e dokumenteve të nevojshëm për ndryshimin e drejtuesit teknik” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së U Gramsh, për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR ka licencuar shoqërinë U Gramsh me vendimin nr. 41, datë 6.10.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës Gramsh” , i ndryshuar me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik.

4. Drejtuesi teknik i shoqërisë U Gramsh sh.a, z. Bledjan Koçi, zotëron diplomë master shkencor në Inxhinieri Hidroteknike, marrë në nëntor 2017.

5. ERRU, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e U Gramsh sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i U Gramsh është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR nr. 41, datë 6.10.2017 “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës Gramsh” , i ndryshuar bëhen këto ndryshime:

“Drejtues Teknik z. Bledjan Koçi”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani